



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

## V E N D I M

**Nr. 169, datë 18.12.2020**

### PËR

**TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 10, DATË 05.02.2020 TË KËSHILLIT BASHKIAK**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, të Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”, vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të këshillit të ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, si dhe bazuar në vendimin e marrë nga Komisioni i Strehimit, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

### V E N D O S I :

1. Të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë me kusht për individët/ familjet, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë 1 (një vjeçare), nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.
3. Për individët/familjet, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, kryerja e pagesave do të kryhet pasi të dorëzohet numri i llogarisë së qiradhënësit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga pika “1”, në shumën prej **821306 lekë** në muaj, do të përballohen nga fondi i përcaktuar nga zëri i bonusit të strehimit të buxhetit të Bashkisë Tiranë.
4. Aneksi nr. 1 bashkëlidhur vendimit nr. 10, datë 5.02.2020 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit ”Subvencioni i qirasë”, hiqet.
5. Ngarkohen Drejtorja e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

**K R Y E T A R**

**ROMINA KUKO**